

2

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIA PROTIV KORUPCIONJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep:	Nr. Prot:
Dep: <u>D-P</u>	Prot No: <u>03-466/11</u>
Nr. Prot:	Data:
Prot. Matrica:	Data: <u>30.11.2011</u>
Nr. Prot:	Data:

Nr. regj. 37298/2011

**GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Granit(Xhevat)Berisha, nga Prishtina, për kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 18.11.2011 morri këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Granit(Xhevat)Berisha, i lindur më 20.06.1984 në Prishtinë, tani me vendbanim në Rrugën “Ndue Perleshi”, nr. 10, Lagja “Mati I”, në Prishtinë, ka kryer fakultetin Ekonomik-dega e menaxhmentit, i martuar pa fëmijë, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë i padënuar,

**Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s**

1. Sepse pas emërimit në pozitën e Kryeshefit të Agjencisë për Mbështetje të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, ashtu si e parasheh ligji, -
  - me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, andaj i shqiptohet

**D Ë N I M**

Me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej 26(njëzetegjashtë) ditësh, duke llogaritur për çdo 15 €, nga 1(një) ditë burgu. Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar ta paguajnë shumën prej nga 5 €, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën nr. 01-4100/2011 me datë 26.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Granit Berishës, për kundërvajtjen nga neni 7 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, Nr. 04/L-050 duke kërkuar që i njëjti të shpallët përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se postin e ka marr më datë 27.07.2011 mirëpo për shkaqe teknike dy javë më vonë ka filluar me punua. Ka marr me e-meil informatën për obligimin e deklarimit të pasurisë, por për shkak të ngarkesës në punë dhe mos njohjes së Ligjit, duke mos pasur njohuri se mos deklarimi është i ndëshkueshëm nuk e ka bërë deklaruar pasurisë me marrjen e postit.

Posa ka kuptuar për rendësin e deklaramit e ka deklaruar pasurinë. Ka pranuar kundërvajtjen duke theksuar se kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin. Është relativisht i ri dhe kjo është përvoja e parë e tij në punën e zyrtarit të lartë publik, duke premtuar se tani e tutje do të këtë kujdes të shtuar.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimit të deklaratës së të pandehurit, vlerësimit të provave të tjera secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja ka konstatuar këtë gjendje faktike: se i pandehuri Granit Berisha, si zyrtar i lartë publik në pozitën Kryeshefit të Agjencisë për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, në Prishtinë, nuk e ka bërë deklaramin e pasurisë me marrjen e detyrës së zyrtarit të lartë publik, andaj në masë të mjaftueshme vërtetoi se ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihen në barrë. Duke pas parasysh se në kohën e kryerjes së kundërvajtjes ka qenë në fuqi Ligjit për Deklaramin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, Nr. 03/L-151, i cili është më i favorshëm për palën, gjyqtaria aplikoj këtë ligj.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurit si dhe shkallën e përgjegjësisë si dhe duke pas parasysh se është hera e parë që bije ndesh me ligjin i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktvendimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe i pandehuri në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**  
Nr. Regj. 37298/2011, më datë 18.11.2011

Gjyqtaria  
Azra Cakolli

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh. Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.